

Referenca e kushteve për: “Iniciativa Lokale për ruajtjen e Biodiversitetit në Rajonin Ohër-Prepë”

Shoqata "Unë, Gruaja"

Lloji i kontratës: OFRUES i SHËRBIMIT – Iniciativa Lokale për ruajtjen e Biodiversitetit në Rajonin Ohër-Prepë – Projekti “Aktorët lokalë dhe ndërkufitarë punojnë së bashku në mbrojtjen e mjedisit të rajonit Prepë-Ohër.”

Fondi në dispozicion 300-1000 euro/aktiviteti

Fondi limit 3000 euro. Do të mbështeten 3-10 aktivitete gjithësej.

Data e shpalljes: 01.03.2022

Afati për aplikim 01.03.2023 – 30.05.2023

1. Informacione të përgjithshme për “Unë, Gruaja”

“Unë, Gruaja” është një organizatë jofitimprurëse, jopolitike, jofetare, e cila është regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar, si shoqatë lokale në vitin 2003. Shoqata ka kontribuar për përmirësimin e barazisë politike dhe sociale mes burrave. dhe grave.

Aktivitetet e shoqatës “Unë, Gruaja” përfshijnë: shërbimet e këshillimit; trajnime; ndërgjegjësimin e publikut; shpërndarja e informacionit; pjesëmarrja e grave në vendimmarrjen lokale; monitorimi i vendimeve të pushtetit vendor nga këndvështrimi gjinor; avokimi dhe lobimi në nivel lokal dhe kombëtar; dëgjesa publike; karvane mjedisore; karvane portokalli; etj.

2. Qëllimi i Shërbimit

Shoqata "Unë, Gruaja" Pogradec (UG) ka filluar zbatimin e projektit "Aktorët lokalë dhe ndërkufitarë punojnë së bashku në mbrojtjen e mjedisit të rajonit Prepë-Ohër ", i cili ka për qëllim kryesor të forcojë kapacitetet e komunitetit në rajon rreth mbrojtjes së biodiversitetit përmes shkëmbimit të praktikave më të mira dhe njohurive ndërmjet aktorëve në të gjithë Rajonin e Liqenit të Ohrit (LOR).

Gjatë zbatimit të projektit, UG do të mbështesë çdo vit iniciativa të vogla nga aktorë lokalë apo organizata që operojnë në zonën përreth Liqenit të Ohrit, si dëgjesa publike, debate, protesta, marshime, karvane të gjelbra, etj, për të rritur ndërgjegjësimin në komunitetin, për të ndikuar qeverisjen lokale dhe institucionet për menaxhimin më efektiv të rajonit ndërkufitar Ohër-Presepë, duke u fokusuar kryesisht në mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.

Çdo vit, do të organizohen të paktën 3 aktivitete të përbashkëta avokuese në zonat ndërkufitare të Zonës së mbrojtur (ZM) gjatë ditëve Ekologjike Ndërkombëtare/Europiane/Kombëtare/Lokale, si Dita e Tokës (22 Prill); Dita e Diversitetit Biologjik (22 Maj); Dita Botërore e Mjedisit (5 Qershor); Dita e Liqenit të Ohrit (21 Qershor). Aktivitetet janë planifikuar të zhvillohen gjatë periudhës Mars-Gusht 2023.

Plotësoni formën e Aplikimit që ndodhet më poshtë këtij njoftimi.

3. Rolet dhe përgjegjësitë që duhet të përmbushë aplikanti:

- Përcakton qëllimin e aktivitetit, tematikën dhe rezultatet e pritshme
- Përcakton target grupin, vendin dhe datën e aktivitetit.
- Përcakton një buxhet me zëra të detajuara për shpenzimet e nevojshme
- Siguron realizimin e aktivitetit/iniciatives
- Është përgjegjës për përgatitjen e raportit.
- Është përgjegjës për përgatitjen e një materiali për t'u publikuar në rrjetet sociale, në lidhje me çështjen më sensitive të aktivitetit.

4. Kërkohet eksperiencë për aplikantin

- Njohuri mbi çështjet mjedisore dhe Biodiversitetin.
- Eksperiencë në angazhimin me shoqërinë civile me fokus të veçantë në mjedis, ndërgjegjësimin, informimin dhe pjesëmarrjen e publikut.
- Aftësi të forta komunikimi dhe advokacie.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë të plotësuar Formën e Aplikimit - Annex 1.

Thirrja është e hapur nga 01.03.2023 – 30.05.2023

Aplikimi mund të dorëzohet:

me e-mail në adresën: une_gruaja@yahoo.com

ose

me postë në një zarf të mbyllur në adresën e mëposhtme:

Shoqata "Unë, Gruaja"

Lagja 1, Rr.Rreshit Çollaku, Pogradec

Shënim:

-Zarfi duhet të ketë gjithashtu informacionin:

Aplikimi: **Iniciativa Lokale për ruajtjen e Biodiversitetit në Rajonin Ohër-Prepë**

Aneks 1

FORMA E APLIKIMIT

AFATI PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE: 01.03.2023 – 30.05.2023
ADRESA E-MAIL PËR VERSIONIN ELEKTRONIK TË APLIKIMEVE: une_gruaja@yahoo.com

TITULLI I APLIKIMIT TE INICIATIVIVES LOKALE:	
BUXHETI:	
VENDNDODHJA E INICIATIVIVES LOKALE TE PROPOZUAR	
KOHËZGJATJA E ZBATIMIT (nga-në / datat e sakta)	

I. BACKGROUND I APLIKANTIT

DETAJET E KONTAKTIT TË APLIKANTIT (grupe aktive dhe/ose OJQ)	
EMRI DHE DETAJET E KONTAKTIT TË APLIKANTIT. (Emri, Mbiemri, Email, Cel.)	
LISTONI NDONJË PËRVOJË TË KALUAR TË NGJASHME	

II. PËRSHKRIMI I INICIATIVIVES LOKALE DHE EFIKASITETI I SAJ

1. Përshkruani dhe analizoni problemin - (maksimumi 300 fjalë)

Përshkruani çështjet që synoni të trajtoni me iniciativën tuaj dhe rëndësinë e saj.

2. Çfarë lloj aktivitete planifikoni të organizoni për të arritur rezultatet e INICIATIVËS TUAJ dhe një afat kohor të detajuar (maksimumi 300 fjalë)? Kush janë grupet e synuara në këtë aksion?

Përshkruani grupet e synuara, nevojat e tyre dhe numrin e parashikuar të personave, që do të përfshihen drejtpërdrejt. Si do ta informoni, motivoni dhe angazhoni grupin e synuar të kësaj iniciative?

III. Bëni një Prezantim të Vetes

Përshkruani shkurtimisht veten, përvojën tuaj, qëllimin tuaj për këtë iniciativë dhe çfarë planifikoni të bëni për ta bërë veprimin tuaj një manifestim publik. Bëhu origjinal.

IV. Buxheti (përshkruani nevojën dhe shumën përkatëse të buxhetit)

Kostot e lidhura me iniciativën: ekspert/ë, materiale, furnizime, printime, etj.

Shenim: Buxheti do të jetë objekt i diskutimit dhe negocimit me UG, për të saktësuar kostot e lejuara.